



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

V E N D I M

Nr. 492 , datë 10.7.2019

PËR

**“MIRATIMIN E CMIMEVE DHE KATEGORIVE OË PËRFITOJNË FALAS
TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN PËR VITIN
SHKOLLOR 2019 - 2020”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit 16/2018, “Për diasporën”, të ligjit nr.9616 datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të pikës 19 të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Qendra e Botimeve për Diasporën me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, boton dhe siguron falas, për vitin shkollor 2019-2020, tekstet shkollore dhe ato plotësuese sipas listës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kategoritë që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit sipas përcaktimeve në vendimin nr.443 datë 26.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.
3. Tekstet shkollore dhe ato plotësuese të botuara, të siguruar, nga Qendra e Botimeve për Diasporën duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni si dhe me pullën hologramë, të certifikimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Qendra e Botimeve për Diasporën siguron pullën me hologramë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kundrejt pagesës.
4. Çmimet e teksteve shkollore dhe ato plotësuese për mësimdhënien në diasporën shqiptare vendosen në kopertinat e tyre përkatëse, në përputhje me listën 1 bashkëlidhur këtij vendimi.



5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.
6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

ANILA DENAJ



**LISTA E TEKSTEVE SHKOLLORE PËR DIASPORËN
PËR VITIN SHKOLLOR 2019 – 2020**

Nr.	Titulli	Tirazhi	çmimi për copë / lekë
1	Abetare <i>(Shkronjë pas Shkronje)</i>	3215 copë	507 lekë
2	Fletore pune Abetareje	2775 copë	243 lekë
3	Gjuhë shqipe 2	1510 copë	453 lekë
4	Fletore pune 2	330 copë	250 lekë
5	Gjuhë shqipe 3	945 copë	394 lekë
6	Fletore pune 3	330 copë	300 lekë
7	Gjuhë shqipe 4	310 copë	460 lekë
8	Fletore pune 4	200 copë	300 lekë
9	Gjuhë shqipe 5	185 copë	530 lekë
10	Fletore pune 5	150 copë	250 lekë
11	Gjuhë shqipe 6	85 copë	539 lekë
12	Fletore pune 6	50 copë	250 lekë



13	Histori e Shqipërisë 9	220 copë	297 lekë
14	Gjeografi e Shqipërisë 9	220 copë	284 lekë
15	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1 / Sete shkollore për fillestarë	120 copë	346 lekë
16	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 2 / Sete shkollore për më të rritur	150 copë	346 lekë
17	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3/ Sete shkollore për më të rritur	150 copë	346 lekë
18	Matematika 1	24 copë	530 lekë
19	Matematika 2	24 copë	291 lekë
	TOTALI	10 993 copë	4.231.499 lekë